



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:265907

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05529146

KF.nr.268/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “BCG” Sh.P.K. me numër unik identifikues 810045981 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Legues”, Sh.P.K. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me paditën e paditësit për anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me 26.03.2024, në prani të avokatit të palës paditëse N.S. dhe të përfaqësuesit të palës së paditur B.G., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit “BCG” Sh.P.K, me seli në Prishtinë.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/4755/2020 i datës 19.10.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 25.11.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit 01.3.2.2/4755/2020 të datës 19.10.2021, për shkak se nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore (neni 16 pika 1.1 të LKA-së), për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike (neni 16 pika

1.3 të LKA.). Padinë e ka arsyetuar se dogana nuk i është përgjigjur në asnjë pikë të aktgjykimit nr.877/20 të datës 15.07.2021, dhe se të njëjtën kërkesë e refuzon duke konsideruar se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë, me çka i ka ngritur bazën Doganore, respektivisht ka konstatuar se kodi tarifor i deklaruar nga subjekti në procedurë për mallin lëndor kontestues nuk është i duhuri. Gjatë seancës gjyqësore ka deklaruar se vendimi kontestues është marrë në kundërshtim me dokumentet përcjellës të mallit lëndor, pasi në të gjitha dokumentet e dorëzuara pranë të paditurës është dëshmuar qartë se malli i deklaruar është në kodin tarifor sipas dokumentacionit përcjellës. Ka shtuar e konsiderojnë se klasifikimi tarifor i mallit i cili përcaktohet sipas rregullave të përgjithshëm për interpretim të TARIKUT ka gabuar në rastin e vlerësimit se ky mjetë është traktor transportues por që i njëjti në bazë të dokumentacionit dhe fotove të bashkangjitura në padi dëshmohet qartë se nuk është i tillë. Ndërsa për vërtetim se malli është deklaruar në mënyrë të saktë paditësi pranë të paditurës ka paraqitur faturën e mallit, certifikatën e konformitetit të lëshuar nga BE si dhe me të njëjtën është konsideruar edhe nga QAK si traktor. Prandaj bazuar si në këto dokumentacione dhe prova të ofruar gjykatës paditësi vlerëson që e paditura me vendimin kontestues në lidhje me ndryshimin tarifor e ka bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe të KDAK-së si dhe e njëjta nuk ka përfillur vërejtjet e dhëna nga gjykata me vendimin A.nr 877/20 pasi që gjykata i ka dhënë vërejtjet dhe kërkesat për përmirësime në lidhje me kodin tarifor gjë të cilën e paditura nuk e ka përfillur. Tutje sqaron për gjykatën se përfaqësuesi i të paditurës zotëri E.G. me mendimin tarifor nr. 11 të datës 22.01.2020 në seancën e dt. 15.07.2021 ka deklaruar se ky mendim tarifor është revokuar me të cilën paditësi është ngarkuar me pagesa shtesë të detyrimeve doganore. Ndërsa sa i përket mendimit tarifor 111 i dt. 15.10.2021 i njëjti fare nuk i është dorëzuar paditësit dhe nuk ka mundur që të veprojë apo ta kundërshtojë të njëjtin mendim tarifor edhe pse këto mendime tarifore janë mendime të brendshme nga ana e të paditurës. Me propozim për gjykatën që pas administrimit të provave të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, të anulojë vendimin kontestues si dhe të obligoj të paditurën që t'ia kthej paditësit mjetet e paguara më tepër në emër të taksës doganore në shumë prej 5,259.70 euro me kamatë vjetore prej 8% nga paraqitja e padisë me dt. 23.11.2021.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 02.08.2021 ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Po ashtu gjatë seancës gjyqësore e paditura e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka shtuar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe mbesim në tërësi sipas sqarimeve dhe elaborimeve si në arsyetimin e nxjerrë të vendimit nga Dogana e Kosovës. Thekson se zyra doganore ka vepruar drejtë kur për mallin e deklaruar paditësin në procedurë e ka udhëzuar të paguajë taksa doganore

pasi që deri te ky vendim është arritur duke u bazuar në mendimin e sektorit të tarifës (Sektor profesional për klasifikimin tarifor të mallrave) të cilat kanë lëshuar mendim për klasifikim tarifor të mallit me karakteristika dhe destinim të njëjtë për tjetër subjekt, andaj meqenëse kemi të bëjmë me karakteristika dhe destinim të mallit të njëjtë është konstatuar se numri tarifor i deklaruar nga paditësi në procedurë për mallin lëndor kontestues nuk është i duhuri. Andaj e paditura pas udhëzimeve dhe vërejtjeve të gjykatës të lëshuar nga organi i shkallës së parë sektori për shqyrtime të vendimeve me qëllim të marrjes të një vendimi në mënyrë sa më meritore ka kërkuar mendim të ri për klasifikim tarifor lidhur me mallin lëndor. Sektori i tarifës ka nxjerrë mendimin me nr. 111/15.10.2021 i cili i ka dhënë të gjitha sqarimet në atë mendim. Bazuar në sqarimet e nxjerra nga sektori i tarifës mendojnë se kodi i tarifor lidhure është 8703211000 prandaj ky klasifikim bazohet në rregulla të përgjithshme nr. 1 dhe 6 për interpretimin e TARIKUT në bazë të shënimeve shpjeguese të nomenklaturës të kombinuar për seksionin XVII shënime të kapitullit 87 të kreut 8701, dokumenteve të bashkangjitura në lëndë, fotove të mjetit motorik, informatave tarifore nga vendet e BE si dhe informatat e tjera të marra nga interneti për mjetet motorike. Andaj e paditura nuk ka mundur të vendos ndryshe përpos vendimit të marrë duke lënë në fuqi DUD R17866/07.04.2020 ZBD Prishtinë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 22.02.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi 01.3.2.2/4755/2020 i datës 19.10.2021, Aktgjykimi A.nr. 877/2020 , Aktvendimi nr. 01.3.2.2/4755 i datës 08.05.2020, Ankesë e datës 17.04.2020, DUD R -17866 i datës 07.04.2020, Pëlqim i datës 06.04.2020, Certifikatë e konformitetit 17.02.2020, Shënimet e Tarikut kreu 8709 , CMR, Faturë nr. 2020-28, Pagesë e datës 24.03.2020, Email i datës. 07.04.2020, Fotot e mallit lëndor, Urdhër pagesë e datës 07.04.2020, Pagesë e datës 07.04.2020, Mendim për klasifikim tarifor nr. 111 i datës 15.10.2021, Mendim për klasifikim tarifor nr. 11 i datës 22.01.2020, Mendim për klasifikim tarifor nr. 39 dt. 06.05.2020, Email i datës 13.07.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklarimet në ankesë/padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se paditësi me anë të DUD-it R-17866 të datës 07.04.2020, në Zyrën së

Brendshme Doganore në Prishtinë, ka paraqitur mallin lëndor për zhdoganim me numrin tarifor 87032110, me ç'rast i njëjti është proceduar, por duke u ri-klasifikuar nga e paditura në kod tjetër tarifor. Paditësi i pakënaqur me këtë vendim ka ushtruar ankesë tek e paditura e cila të njëjtën e ka refuzuar, e ndaj vendimit të së cilës paditësi ka ushtruar padi. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin A.nr. 877/20 të datës 15.07.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që ka anuluar aktvendimin nr.01.03.2.2/4755 të datës 08.05.2020 dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. E paditura duke vepruar sipas aktgjykimit të lartcekur, e ka rishqyrtuar vendimin dhe serish e ka refuzuar ankesën e këtui paditësit. Paditësi përsëri ka ushtruar padi e cila është ka iniciuar këtë konflikt administrativ në Gjykatë duke theksuar se e paditura nuk i është përmbajtur aktgjykimit A.nr. 877/20.

Kontestuese në mes të palëve mbetet nëse mjetei i zhdoganuar në ZBD Prishtinë është zhdoganuar me numër të drejtë tarifor siç është udhëzuar nga e paditura.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura me aktvendimin kontestues e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e DUD R-17866/07.04.2020. E paditura ka vlerësuar se sektori për kundërvajtje doganore ka vepruar drejtë kur subjektin në procedurë e ka udhëzuar të paguaj taksat doganore, pasi deri te ky vendim i tillë është arritur duke u bazuar në mendimin e Sektorit të Tarifës (Sektor Profesional për Klasifikim Tarifor dhe i mallrave) të cilët kanë lëshuar mendim për klasifikim tarifor të mallit me karakteristika dhe destinim të njëjtë dhe se kodi tarifor i deklaruar nuk është i duhuri.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Konform nenit 44 të LKA-së, Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiisë. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet tjera të paditësit, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, dhe sipas Mendimit mbi klasifikim tarifor nr. 111 të datës 15.10.2021 Dogana e Kosovës ka konstatuar se subjekti "BCG" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, kontrollit Doganor nuk i ka deklaruar saktë kodin tarifor të mallit për mallin e deklaruar me anë të deklaratës doganore dhe se e ka deklaruar mallin me kodin tarifor

8701931000 si traktor bujqësor, ndërsa sipas mendimit mbi klasifikim tarifor nr. 111/15.10.2021, i njëjti mall duhet të deklarohet në kodin tarifor 8703 2110 00, sepse i njëjti nuk i plotëson të gjitha kushtet për tu klasifikuar si mjet motorik i kreut 8701 dhe si i tilli i konstruktuar dhe destinuar për qëllime rekreative, pra ka tiparet e mjetit për udhëtar, sikurse janë ulëset njëra për vozitësin dhe njëra për pasagjerin, dhe nuk kemi të bëjmë me traktor bujqësor dhe si i tillë i përshtatet kodit tarifor për mjete të tjera të transportit të udhëtarëve të kreut 8703.

Pretendimin e paditësit se malli është deklaruar në mënyrë të saktë pasi që paditësi panë të paditurës ka paraqitur faturën e mallit, certifikatën e konformitetit të lëshuar nga BE si dhe me të njëjtën është konsideruar edhe nga QAK si traktor, Gjykata nuk e pranon si të drejtë për faktin se homologimi ka të bëjë me vlerësimin e konformitetit teknik të mjetit bazuar në kushtet sipas legjislacionit të atij vendi dhe nuk është dokument përcaktues për klasifikim tarifor të mallit sipas legjislacionit në fuqi.

Me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, decidivisht parashihen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore për aranzhime preferenciale ku me paragrafin 1, pika C përcaktohet se *“Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruara”*.

Gjykata konstaton se dokumenti i vetëm me të cilin paditësi do të mund të dëshmonte klasifikimin tarifor ndryshe nga konstatimet e të paditurës në mendimin tarifor 111/15.10.2021 si dhe mendimin nr.39/06.05.2020, është Informata Tarifore Detyruese e lëshuar nga autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian, por të cilin paditësi nuk e ka prezantuar as në procedurë administrative tek e paditura dhe as në këtë gjykatë gjatë zhvillimit të kontestit administrativ.

E paditura, për DUD-in kontestues, ka kërkuar mendim për klasifikim tarifor nga Sektori i Tarifës në kuadër të Doganës, e i cili Sektor me datë 15.10.2021, ka lëshuar mendimin për klasifikim tarifor nr. 111, e sipas të cilit mendim, kodi tarifor i deklaruar nga këtu paditësi nuk është i duhuri dhe se kodi tarifor i duhur është 8703211000, kjo bazuar në rregullat e përgjithshme numër 1 dhe 6 për interpretimin e TARIK-2020, shënimet shpjeguese të nomenklaturës së kombinuar për Seksionin XVII, shënimet e kapitullit 87, të kreut 8701, dokumenteve të bashkangjitura në lëndë, fotove të mjetit motorik, informatave tarifore nga vendet e Unionit Evropian si dhe informatave tjera të marra nga interneti për mjete motorike.

Sipas nenit 43, par 1. të LKA-së, *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”*. Rrjedhimisht, paditësi në këtë

konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat, përkatësisht informatën tarifore detyruese lidhur me klasifikimin tarifor të mallit për DUD-in kontestues, e me të cilin do të mbështeste pretendimet e tij si në padi, e që është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.268/22, datë 26.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.